

Bordi i Drejtoreve të KRU "Mitrovica" Sh.A bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, nenit 4 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, si dhe bazuar në nenin 7 në Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A në mbledhjen e mbajtur me datë 21.06.25 aporvoi këtë:

RREGULLORE NR. 3112 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.1347/2 MBI SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË PUNËVE DHE DETYRAVE TË PUNËS TË KOMPANISË RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A. NË MITROVICË

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullore nr.1347/2 mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës te KRU,, Mitrovica,, Sh. A.

Neni 2

Plotësohet Rregullorja mbi sistematizimin e Vendeve të Punes ku për pozitat që publikohen në pjesën me shumicë serbe njohja e gjuhës serbe të konsiderohet si përparësi.

Neni 3

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i rregullores përkatëse, për tu harmonizuar me plotësimet e përdorura në këtë Rregullore.

Neni 4

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të KRU,, Mitrovica,, Sh.A.- Mitrovicë si dhe publikimit të saj në ueb-faqen e Kompanisë.

KRU,, Mitrovica,, Sh.A – Mitrovicë

Kumrije Kelmendi Aliu - Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

